



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

L I G J

Nr. 9355, datë 10.03.2005

PËR NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE

Në mbështetje të nenit 78, 83, pika 1, të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I :

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1

Ky ligj ka për qëllim:

1. Të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.
2. Të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre.

NENI 2

Ky ligj rregullon marrëdhëniet e financimit e të ofrimit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në Shqipëri.

NENI 3

Parimet bazë, mbi të cilat funksionon skema e ndihmës dhe e shërbimeve shoqërore, janë:

- a) respekti dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit;
- b) universaliteti;
- c) barazia e mundësive;
- d) e drejta për të përfituar;
- e) partneriteti;
- f) trasparenca dhe paanshmëria;
- g) decentralizimi;
- h) pavarësi, integrim shoqëror dhe pjesë-marrje në jetën e komunitetit;
- i) mosdiskriminimi;
- j) karakteri subvencionues.

NENI 4

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Ndhmë ekonomike” kuptohet mbështetja, në para e natyrë, e individëve me status të veçantë dhe e familjeve në nevojë.
2. “Pagesë për personat me aftësi të kufizuar” kuptohet pagesa mujore, në lekë, që u jepet personave me aftësi të kufizuar, sipas përcaktimit të këtij ligji.
3. “Person me aftësi të kufizuar (PAK)” kuptohet individi, të cilit i është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisror, të intelektit, psikiko/mendor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të përkohshme apo të përhershme, të cilat nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin.
4. “Invalid pune” kuptohen individët që janë deklaruar të tillë me vendim të KMCAP që përfitojnë nga ligji Nr. 7889, dt. 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidëve” i ndryshuar.
5. “Shërbime shoqërore” kuptohet tërësia e shërbimeve që u ofrohet individëve dhe grupeve në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të përballojnë, me burimet që kanë, nevojat e tyre jetësore, për ruajtjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e mundësive individuale, për të kapërcyer nevojat emergjente apo kronike.
6. “Njësi e pushtetit vendor” kuptohet bashkia/komuna, ku subjektet përfituese, sipas këtij ligji, ushtrojnë të drejtën për të kërkuar kompensimin e të ardhurave materiale ose/dhe monetare, të cilat u mungojnë plotësisht ose pjesërisht, si dhe për shërbime shoqërore.

7. "Administrator shoqëror" kuptohet nëpunësi civil i organeve të pushtetit vendor, i cili administron shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët në nevojë.
8. "Familje", kuptohet një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore, si dhe marrëdhëniet prindër-fëmijë, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë, që jetojnë në të njëjtën strehë.
9. "Familje kujdestare", kuptohet një familje alternative, sipas përkufizimit të dhënë në nenin 266 të ligjit nr. 9062, dt. 08.05.2003.
10. "Kryetar të familjes", kuptohet personi sipas kësaj renditjeje: babai, nëna, anëtari më i madh i familjes, në grup-moshën aktive (18-65 vjeç), anëtari më i ri i familjes, në grup-moshën mbi 65 vjeç, dhe kujdestari kur të gjithë anëtarët e familjes janë nën moshën 18 vjeç.
11. "Familje të varfra", kuptohen familjet, që nuk kanë të ardhura materiale ose/dhe monetare, ose i kanë të pamjaftueshme, nga veprimtaria ekonomike, programe të tjera të mbrojtjes shoqërore dhe kapitali.
12. "Familje bujqësore" kuptohet familja, që ka në pronësi tokë të punueshme, pavarësisht nga vendndodhja e familjes apo e tokës.
13. "Të ardhura të familjes" kuptohen të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes, nga çdo lloj burimi, duke përfshirë dhe ata që përkohësisht jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit. Nuk përfshihen në të ardhurat e familjes pagesat që marrin pjesëtarët e familjes me aftësi të kufizuara mendore, fizike, të verbrit, paraplegjikët e tetraplegjikët, përfitimet e invalidëve sipas Statusit të Invalidit të Punës, si dhe pagesat për fëmijët e lindur si trinjakë a më shumë.
14. "Jetim" kuptohet fëmija pa prindër, deri në moshën 25 vjeç, sipas përcaktimit të bërë në statusin e jetimit.
15. "Shërbime shoqërore në komunitet" kuptohen të gjitha llojet e shërbimeve shoqërore, publike dhe jopublike, që kryhen në nivel vendor, në territorin, në juridiksionin e bashkisë/komunës.
16. "Person i moshuar" kuptohet personi, që ka arritur moshën e pensionit të pleqërisë, sipas legjislacionit në fuqi.
17. "Vendbanim" kuptohet vendi ku familja ose personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.
18. "Vendqëndrim" kuptohet vendi ku banohet për një kohë të caktuar për arsye pune, studimi, trajtimi mjekësor, pushimi, shërbimi të detyruar ushtarak apo vuajtjeje dënimi, si dhe raste të tjera të kësaj natyre.
19. "Burime jetese" kuptohen të gjitha mjetet monetare ose të ardhurat në natyrë, të cilat bëjnë të mundur jetesën.
20. "Veprimtari ekonomike" kuptohet çdo veprimtari, në formën e punësimit, të vetëpunësimit, të punës që kryhet pa pagesë pranë një anëtari të vetëpunësuar të familjes, si dhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme, që sjell të ardhura për individët dhe familjet e tyre.

21. "Kapital" kuptohet çdo lloj prone/pasurie që mund të sjellë të ardhura.
22. "Veprim i qëllimshëm" kuptohet çdo veprim që synon të shmangë punësimin e shpërblyer, kualifikimin për punësim dhe për mundësi punësimi, trajtimin mjekësor në rastet e përdoruesit të drogës ose të përdoruesit me tepri të alkoolit, mospërdorimin e kapitalit atje ku është mundësia për të siguruar mjetet e domosdoshme të jetesës, dhënies reale të të ardhurave, si dhe çdo veprim që nxit ndarjen e familjeve, që vërtetohet se kanë të njëjtën strehë, për përfitim nga ndihma ekonomike.

KREU II

PËRFITUESIT E NDIHMËS DHE TË SHËRBIMIT SHOQËROR

NENI 5

Përfitues të ndihmës ekonomike janë:

1. Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme;
2. Jetimët mbi 25 vjeç, të papunë, të cilët nuk janë në institucione ose nën kujdestari;
3. Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë.

NENI 6

Përfituesit e shërbimeve shoqërore janë fëmijët, të rinjtë deri në moshën 25 vjeç, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, gratë, vajzat në nevojë, si dhe të gjithë ata që janë në rrezik të bëjnë pjesë në grupet në nevojë.

NENI 7

Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë:

1. Të verbrit, me mungesë të plotë ose të pjesshme të shikimit, të lindur ose të fituar, të cilët janë deklaruar të paaftë për punë, me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë (KMPV).
2. Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët deklarohen, me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), se janë bërë të tillë pavarësisht nga shkaku dhe mosha.

3. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).
4. Personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune, me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), përfitojnë një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, sipas Statusit të invalidit të punës.

NENI 8

Personat përfitues që përcaktohen në pikën 1, 2, 3 të nenit 7 të këtij ligji, të cilët me vendim të komisioneve mjekësore të posaçme përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një kujdestar me pagesë.

NENI 9

Nga ky ligj nuk përfitojnë:

1. Shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit si emigrantë, me përjashtim të personave dhe të familjeve të tyre të caktuar me punë pranë përfaqësive tona diplomatike dhe organizmave ndërkombëtare.
2. Azilkërkuesit, të cilët nuk kanë marrë statusin e azilantit.
3. Shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi të cilët kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe e luftërave.

KREU III

LLOJET E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

NENI 10

Ndihma ekonomike jepet në formën e një kësti mujor, në lekë, ose përfitimi mujor, në natyrë për kategoritë e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

Masa mujore e ndihmës ekonomike në vlerë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

NENI 11

1. Pagesa për personat me aftësi të kufizuara jepet në formën e një kësti mujor, në lekë. Masa e pagesës për këta individë dhe për kujdestarët e tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Përfituesit e përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, të klasifikuar me vendim të komisioneve mjekësore të aftësisë, në grupet e dyta të paaftësisë, humbasin të drejtën e pagesës së aftësisë së kufizuar, në çastin e punësimit të tyre.

NENI 12

Shërbimet shoqërore, sipas natyrës, ndahen në:

1. shërbime të përkujdesit shoqëror;
2. shërbime të përkujdesit shoqëror-mjekësor.

NENI 13

1. Shërbimet e përkujdesit shoqëror përfshijnë shërbimet që u ofrohen individëve, familjeve, grupeve në nevojë, komuniteteve, të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, për plotësimin e nevojave të tyre jetësore.
2. Shërbimet e përkujdesit shoqëror-mjekësor ofrohen nga personeli i specializuar, në qendra riintegruese dhe rehabilituese rezidenciale, qendra ditore apo në familje, për individët, të cilët nuk janë në gjendje të jetojnë normalisht, për shkak të përkeqësimeve, të përkohshme apo të përhershme, fizike, psikike, mendore dhe sensore.

NENI 14

Shërbimet e përkujdesit shoqëror, sipas mënyrës së organizimit dhe të funksionimit, janë:

1. shërbime të përkujdesit rezidencial;
2. shërbime të përkujdesit komunitar.

NENI 15

1. Shërbimi në institucionet rezidenciale ofrohet për individë, për të cilët përkujdesi në shtëpi nuk është i mundur. Vendosja e tyre në qendrat e përkujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e personit ose përfaqësuesit e tij ligjor, pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të tij.

2. Shërbimet e përkujdesit komunitar ofrohen në qendra ditore, shtëpitë e individëve, apo në familjen kujdestare, sipas nevojave specifike të grupeve përfituese.

NENI 16

Shërbimet e përkujdesit shoqëror, sipas mënyrës së financimit, klasifikohen në shërbime publike dhe shërbime private.

NENI 17

1. Shërbimet shoqërore publike, përfshijnë shërbimet e përkujdesit shoqëror, që ofrohen në institucionet rezidenciale, ditore apo në shtëpi, për grupet në nevojë.
Këto shërbime financohen nga buxheti qendror dhe nga buxhetet e pavarura të organeve të qeverisjes vendore:
 - a) Bashkitë/komunat, administrojnë të gjitha shërbimet shoqërore për individë, që janë banorë të atij qyteti apo komune.
 - b) Qarku, administron shërbime kur ato ofrohen për individë, që u përkasin disa njësive vendore në atë qark.
2. Shërbimet shoqërore private, përfshijnë shërbimet e përkujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat rezidenciale, në qendrat ditore a në shtëpi, të financuara privatisht.

NENI 18

1. Personat juridikë, publikë dhe personat juridikë, privatë, që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, licensohen nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale.
Kriteret dhe procedurat për licensimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Shërbimet shoqërore publike që financo-hen me fondet e buxhetit qendror apo vendor, prokurohen nga organet e pushtetit vendor tek ofruesit privatë të tyre, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.
3. Organet e pushtetit vendor lidhin kontratë me personat juridikë, privatë fitues, për shërbimet që ato ofrojnë në juridiksionin e territorit të tyre.
4. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale harton standardet e shërbimeve shoqërore dhe kontrollon zbatimin e tyre. Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

KRITERET E PËRFITIMIT DHE PROCEDURA E DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE DHE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

NENI 19

Ndihma ekonomike, që përfitojnë familjet në nevojë, është e plotë ose e pjesëshme.

1. Ndhmë ekonomike të plotë përfitojnë familjet ose individët, që nuk kanë të ardhura nga:
 - a) veprimtaria ekonomike;
 - b) programet e ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore ose ndonjë sistem tjetër i mbrojtjes shoqërore;
 - c) kapitali;
 - ç) pjesëtarët e familjes që janë në emigracion.
2. Ndhmë ekonomike është e pjesëshme kur familja pretenduese ka të ardhura të pamjaftueshme nga:
 - a) toka;
 - b) bagëtia, shpendët, bletët, vreshtaria e kopshtaria;
 - c) pensionet dhe të ardhura të tjera.
3. Vlerësimi në koeficient i të ardhurave, të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij neni, për efekt të llogaritjes së ndihmës ekonomike, të plotë apo të pjesëshme, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

NENI 20

1. Ndhmë ekonomike dhe pagesa e personave me aftësi të kufizuar, shpërndahen një herë në muaj me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.
2. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet me shkrim nga kryetari i familjes dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët madhorë të saj. Aplikantët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm tek administratori shoqëror, pranë njësisë së pushtetit vendor. Kriteret dhe procedurat për përfitimin e ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar pagesë për personat me aftësi të kufizuara paraqiten te administratori shoqëror, në njësitë e pushtetit vendor. Kriteret për përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar shërbime të përkujdesit shoqëror paraqiten te administratori shoqëror, në njësitë e pushtetit vendor. Kriteret e pranimit në institucionet e përkujdesit shoqëror dhe për shërbimet në komunitet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

NENI 21

Këshilli i bashkisë/komunës ka të drejtë të miratojë kritere specifike për të dhënë ndihmë ekonomike apo për të ofruar shërbime të përkujdesit me fondet e buxhetit lokal, për familjet me shumë pjesëtarë apo familjet e varfra.

NENI 22

Personat, që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, pranohen në institucionet rezidenciale, publike, pa pagesë, nëse familjet e tyre nuk kanë asnjë të ardhur. Shpenzimet e tyre mbulohen nga buxheti i shtetit.

NENI 23

1. Personat që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, dhe kanë të ardhura personale, pranohen në institucionet publike të përkujdesit, kundrejt një pagese në raport me të ardhurat e tyre mujore ose të ardhurat e individëve të tjerë përgjegjës. Masa e kontributit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Pagesa e personave me aftësi të kufizuar, sipas nenit 7 të këtij ligji, nuk përfshihet në llogaritjen e të ardhurave personale të personave që vendosen në institucionet publike të përkujdesit shoqëror.
3. Përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror që vendosen në institucionet e përkujdesit, u jepen në dorë një shumë në lekë për shpenzime personale. Kjo shumë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

NENI 24

Nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesjes shoqërore, në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare miratohen nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale. Nivelet e kuotave të shpenzimeve në institucionet private nuk mund të jenë më të ulëta se ato në institucionet publike.

NENI 25

Aplikuesi, të cilit i refuzohet kërkesa për përfitim të ndihmës ekonomike, pagesë për aftësinë e kufizuar ose të shërbimit shoqëror me vendim të këshillit të njësisë së pushtetit vendor, ka të drejtë për apelim në gjykatë.

KREU V

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SKEMËS SË NDIHMËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

NENI 26

1. Shërbimi Social Shtetëror është institucion publik në varësi të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale.
2. Statuti i Shërbimit Social Shtetëror miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Shërbimi Social Shtetëror administrohet dhe drejtohet nga Këshilli Administrativ i cili është organi më i lartë vendimmarrës.
4. Funkcionet dhe anëtarësia e Këshillit Administrativ përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Shërbimi Social Shtetëror përgjigjet për zbatimin e politikave të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale në fushën e ndihmës dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për:
 - a) programimin dhe kontrollin e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror;
 - b) hartimin e standardeve të shërbimeve dhe propozimin për miratim të shërbimeve të reja;
 - c) përcaktimin e dokumentacionit unik, të nevojshëm, për aplikuesit dhe përfituesit e shërbimeve shoqërore, sipas këtij ligji.

NENI 27

1. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale është autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave, të legjislacionit, programimin e fondeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore, normave dhe standardeve të shërbimeve, si dhe kontrollin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet e strukturave, qendrore dhe vendore, në sektorin publik dhe privat.
2. Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale ngre Inspektoriatin e Ndhmës Ekono-mike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili kontrollon veprimtarinë dhe zbatimin e legjislacionit në

strukturat dhe institucio-net në varësi të tij dhe seksionet e ndihmës ekonomike në bashki ose komunë, si dhe miraton dokumentacionin e përcaktuar në nenin 26 pika 5 shkronja "c" të këtij ligji.

3. Procedura e kryerjes së kontrollit nga këto inspektoriate përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Për vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave, arritjen e standardeve për ndihmën ekonomike, pagesën për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale grumbullon informacione, statistika dhe raporte nga njësitë e pushtetit vendor. Përmbajtja, periodiciteti dhe treguesit statistikor përcaktohen me VKM.

NENI 28

Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale harton dhe paraqet pranë Ministrisë së Financave, nevojat për fonde nga buxheti për ndihmën ekonomike, pagesën për personat me aftësi të kufizuar dhe për shërbimet e përkujdesit shoqëror.

NENI 29

Këshilli i bashkisë/komunës ka këto përgjegjësi:

1. Miraton fondin dhe numrin e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike.
2. Miraton fondin për pagesën e personave me aftësi të kufizuar.
3. Miraton fondin për shërbimet e përkujdesit shoqëror.
4. Harton planin për zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror bazuar në burimet, nevojat dhe prioritetet vendore.
5. Miraton dhe mbështet zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit në bazë të vlerësimit të nevojave e prioriteteve vendore.
6. Merr vendime për personat, familjet, llojet e shërbimeve shoqërore që do të ofrohen bazuar në:
 - a) vlerësimin e nevojave të individëve dhe familjeve të bëra nga administratori shoqëror;
 - b) mundësitë financiare për ofrimin e këtyre shërbimeve.
7. Vendos, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të drejtën dhe masën e përfitimit të ndihmës ekonomike për familjen, si dhe ofrimin e përfitimeve të veçanta, të parashikuara me ligj.

8. Autorizon strukturat e njësisë së pushtetit vendor të kontraktojnë me ofrues shërbimesh private të licensuara në rastet kur ato shërbime ofrohen nga shërbime shoqërore publike.
9. Me fondet e veta, në bazë të kriterëve specifike, mbështet me ndihmë ekonomike, apo forma të tjera ndihme të menjëhershme, familjet e varfra.
10. Miraton programet për kushtëzimin e ndihmës ekonomike me punë e shërbime në komunitet. Kriteret për kushtëzimin e ndihmës me punë e shërbime në komunitet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
11. Miraton strukturat e institucione në varësi të saj që merren me shpërndarjen e ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe realizimin e shërbimeve të përkujdesit në juridiksionin e saj.
12. Miraton programe bashkëpunimi me OJF-të, institucionet e kultit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, në përputhje me planet kombëtare e rajonale të ndihmës dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

NENI 30

Për administrimin e skemës së ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore, pranë qarqeve dhe bashkive/komunave, ngrihen strukturat përkatëse. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre strukturave, në zbatim të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

NENI 31

Administratorët shoqërorë në bashki/komuna kanë për detyrë:

- a) të identifikojë familjet që kanë nevojë për ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar dhe nevojat e individëve për shërbime të përkujdesit shoqëror;
- b) të verifikojnë gjendjen shoqërore e ekonomike, të familjeve në nevojë kur futen për herë të parë në skemë, si dhe dy herë në vit të gjitha familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike;
- c) të propozojë në Këshillin e Bashkisë/ Komunës familjet në nevojë për të përfituar ndihmë ekonomike;
- d) të ndihmojë në përgatitjen e dokumentacionit, për personat që aplikojnë për përfitimin e: ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar dhe për shërbimet e përkujdesit shoqëror;

- e) të marrë pjesë në procesin e hartimit të projektvendimit për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, të listës së personave me aftësi të kufizuar dhe personave që do të trajtohen me shërbime të përkujdesit shoqëror;
- f) të llogarisë dhe të propozojë për miratim, në seksionin e ndihmës dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror të bashkisë/ komunës, masën e ndihmës ekonomike;
- g) të hartojnë kërkesën për bllok-ndihme dhe fondin e pagesës së personave me aftësi të kufizuar, çdo dymujor për njësinë e pushtetit vendor;
- h) të bashkëpunojnë për hartimin e planeve, vendore dhe rajonale, në mbështetje të personave në nevojë;
- i) të vlerësojnë nevojat e individëve apo familjeve që kërkojnë të marrin shërbime shoqërore në përputhje me prioritetet kombëtare dhe lokale, mundësitë finan-ciare për mbulimin e këtyre shërbimeve, përgatit dokumentacionin dhe propozimet për aprovim në këshillin e bashkisë/ komunës;
- j) të grumbullojë dhe të hartojë informa-cione, statistika, dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të ndjekin shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe të personave që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror;
- k) të grumbullojë informacione për rrjetet e shërbimeve publike dhe private që veprojnë në territorin e bashkisë/komunës.

KREU VI

FINANCIMI I NDIHMËS DHE SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

NENI 32

Shteti ofron shërbime të përkujdesit shoqëror dhe forma të tjera të mbështetjes për personat në nevojë, sipas mundësive të buxhetit të shtetit.

NENI 33

Financimi i programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore, përballohet nga buxheti i shtetit dhe buxhetet e pushtetit vendor.

NENI 34

Burimet e financimit të ndihmës dhe pagesës së personave me aftësi të kufizuar përbëhen nga:

- a) Fondet e Buxhetit qendror të shtetit;
- b) Fondet nga taksat dhe tarifatat vendore.

NENI 35

1. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale programon fondet për bllokndihmën ekonomike dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuar në përputhje me vlerësimin e kërkesave të ardhura nga njësitë e qeverisjes vendore dhe një herë në dy muaj i transferon ato në bashki ose komunë.
2. Kriteret dhe treguesit, që përdoren për programimin e bllokndihmës, propozohen nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

NENI 36

1. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale delegon një herë në 4 muaj fondin e bllok-ndihmës ekonomike në bashki/komuna, të cilat dhënie e ndihmës ekonomike e kushtëzojnë me punë e shërbime të përkujdesit shoqëror në komunitet.
2. Teprica e fondeve të ndihmës ekonomike, e krijuar si rezultat i menaxhimit më të mirë të bllokndihmës, pas miratimit nga MPÇS, i mbetet njësitëve vendore. Këto fonde shërbejnë për të mbështetur programe, që zbatohen për punë ose shërbime në komunitet brenda vitit.

NENI 37

Burimet e financimit për shërbimet e përkujdesit shoqëror, që realizohen nga institucionet, publike dhe jopublike, në nivel qarku ose bashki/komunë, në institucionet rezidenciale, në qendrat ditore, në familje apo shërbime të lëvizshme në komunitet, përbëhen nga:

- a) Fondet e deleguara nga Buxheti qendror i shtetit;
- b) Fondet e caktuara nga taksat dhe tarifatat vendore;

- c) Të ardhurat e caktuara nga pasuritë dhe aktivitete të tjera të bashkisë/komunës;
- d) Kontributet e përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji;
- e) Dhurimet, sponsorizimet dhe financime të tjera nga organizata, persona, fizikë a juridikë, apo individë të tjerë, që nuk përfshihen në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d” të këtij neni.

NENI 38

Fondet nga Buxheti qendror për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, delegohen nga MPÇS në bashki/komunë, qark që në fillim të vitit, në përputhje me vlerësimin e nevojave dhe me mundësitë e buxhetit të shtetit. Metodologjia e llogaritjes dhe e shpërndarjes së këtyre fondeve, përcaktohet nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

NENI 39

Për mbështetjen e shërbimeve të reja të përkujdesit shoqëror dhe zhvillimin e politikave sociale, MPÇS krijon Fondin Shoqëror, i cili përbëhet nga:

- a) një pjesë e fondeve të programuara për shërbimet e përkujdesit shoqëror;
- b) Financime jashtëbuxhetore nga organizata, persona, fizikë a juridikë, apo individë të tjerë;
- c) të ardhurat e tjera, që sigurohen nga zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, që Republika e Shqipërisë lidh me shtetet e tjera;
- ç) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron MPÇS.

Rregullat e përdorimit të Fondit Shoqëror, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

NENI 40

Kontrolli për përdorimin e fondeve të ndihmës, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror bëhet nga organet e

specializuara të kontrollit, në përputhje me ligjin “Për auditimin e brendshëm dhe kontrollin financiar”.

KREU VII

NENI 41 **Sanksionet**

Çdo shkelje e këtij ligji dhe e akteve nënligjore në zbatim të tij quhet kundërvajtje adminis-trative, në mbështetje të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993, “Për kundërvajtjet administrative”.

NENI 42 **Dispozitat kalimtare**

1. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale harton programin e kalimit të institucioneve të përkujdesit shoqëror në varësi të pushtetit vendor.
2. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale harton dhe ndjek procedurat e transferimit të shërbimeve shoqërore dhe kalimin e institucioneve në varësi të qeverisjes vendore, duke filluar nga viti 2005 deri në vitin 2007.
3. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale merr masat për transferimin e fondeve për të gjitha institucionet që transferohen në varësi të qeverisjes vendore.
4. Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale krijon Inspektoriatin e Ndhmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore brenda vitit 2006.
5. Qarqet, bashkitë ose komunat ngarkohen të krijojnë e të plotësojnë strukturat për administrimin e skemës së ndihmës ekonomike, pagesës për aftësinë e kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore, sipas nevojave, brenda vitit 2006.

NENI 43

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve **10, 11, 18, 19, 20, 23, 26, 27, 29, 30, 35, 38 dhe 39** të këtij ligji.

NENI 44

Ligji nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror”, i ndryshuar, vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij dhe neni 2 i ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” shfuqizohen.

NENI 45

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Servet PËLLUMBI